

STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMI 300

PLANIFIKIMI I AUDITIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date)

PËRMBAJTJA

	Paragrafi (ët)
Hyrje	
Objekti i këtij SNA-je	1
Roli dhe Afati i Planifikimit	2
Hyrja në fuqi	3
Objektivi	4
Kërkesat	
Përfshirja e Anëtarëve Kryesorë të Grupit të Angazhimit	5
Aktivitetet Paraprake të Angazhimit	6
Planifikimi i Veprimtarive	7-11
Dokumentimi	12
Konsiderata Shtesë në Angazhimet e Auditimit Fillestare (që kryhen për herë të parë)	13
Zbatime dhe Materiale të Tjera Shpjeguese	
Roli dhe Afati i Planifikimit	A1-A3
Përfshirja e Anëtarëve Kryesorë të Grupit të Angazhimit	A4
Aktivitetet Paraprake të Angazhimit	A5-A7
Planifikimi i Veprimtarive	A8-A17
Dokumentimi	A18-A21
Konsiderata Shtesë në Angazhimet Fillestare të Auditimit	A22

Standardi Ndërkombëtar i Auditimi (SNA) 300 “Planifikimi i një Auditimi të Pasqyrave Financiare” duhet të lexohet i lidhur ngushtë me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 200 “Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.”

Hyrje

Objekti i këtij SNA-je

1. Ky Standard Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) trajton përgjegjësinë e audituesit për të planifikuar një auditim të pasqyrave financiare. Ky standard është shkruar në kontekstin e auditimeve të njëpasnjëshme. Konsideratat shtesë në rastin e një angazhimi fillestar të auditimit janë identifikuar veçmas.

Roli dhe Afati i Planifikimit

2. Planifikimi i auditimit përfshin përcaktimin e strategjisë së përgjithshme për angazhimin dhe zhvillimin e një plani auditimi. Planifikim i përshtatshëm bën që të përfitojë auditimi i pasqyrave financiare në disa mënyra, duke përfshirë faktin që ai: (Ref. Para. A1-A3)
 - Ndhmon audituesin për t'Ë kushtuar vëmendjen e duhur çështjeve të rëndësishme të auditimit.
 - Ndhmon audituesin për të identifikuar dhe zgjidhur problemet në kohën e duhur.
 - Ndhmon audituesin që ai të organizojë dhe të drejtojë si duhet angazhimin e auditimit, me qëllim që auditimi të kryhet në një mënyrë efektive dhe efëçente.
 - Ndhmon në zgjedhjen e anëtarëve të grupit të angazhimit me nivele duhura të aftësive dhe të kompetencës për t'iu përgjigjur rrezikut të parashikuar, dhe në caktimin e punës së duhur tek ata.
 - Lehtëson drejtimin dhe mbikëqyrjen e anëtarëve të grupit të angazhimit si dhe kontrollin e punës së tyre.
 - Ndhmon, kur është e mundur, në koordinimin e punës së bërë nga audituesit e komponentëve dhe ekspertët.

Hyrja në fuqi

3. Ky standard ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date.

Objektivi

4. Objektivi i audituesit është të planifikojë auditimin me qëllim që ai të kryhet në një mënyrë efektive.

Kërkesat

Përfshirja e Anëtarëve Kryesorë të Grupit të Angazhimit

5. Ortaku dhe anëtarë të tjerë kryesorë të grupit të angazhimit do të përfshihen në planifikimin e auditimit, përfshirë planifikimin dhe pjesëmarrjen në diskutimet ndërmjet anëtarëve të grupit të angazhimit. (Ref: Para. A4)

Aktivitetet Paraprake të Angazhimit

6. Në fillim të angazhimit aktual të auditimit, audituesi duhet të ndërmarrë aktivitetet e mëposhtme:
- (a) Të kryejë procedurat e kërkuara nga SNA 220 në lidhje me vazhdimin e marrëdhënieve me klientin dhe angazhimin specifik të auditimit;¹
 - (b) Të vlerësojë pajtueshmërinë me kërkesat përkatëse etike, duke përfshirë pavarësinë, në përputhje me SNA 220;² dhe
 - (c) Të njohë dhe të kuptojë kushtet e angazhimit të auditimit, sikurse kërkohet nga SNA 210.³ (Ref: Para. A5-A7)

Planifikimi i Veprimtarive

7. Audituesi duhet të hartojë një strategji të përgjithshme auditimi që përcakton qëllimin, kohën dhe drejtimin e auditimit, dhe që jep udhëzime për zhvillimin e planit të auditimit.
8. Gjatë hartimit të strategjisë së përgjithshme të auditimit, audituesi do të:
- (a) Identifikojë karakteristikat e angazhimit që përcaktojnë objektin e tij.
 - (b) Përcaktojë objektivat e raportimit të angazhimit për të planifikuar afatin e auditimit si dhe natyrën e komunikimeve që kërkohen.
 - (c) Konsiderojë faktorët që, në gjykimin profesional të audituesit, janë të rëndësishme në drejtimin e përpjekjeve të grupit të angazhimit.
 - (d) Vlerësojë rezultatet e aktiviteteve paraprake të angazhimit dhe, kur është e zbatueshme, të vlerësojë nëse njohuritë e marra në angazhime të tjera të kryera nga ortaku i angazhimit, janë të përshtatshme për entitetin.

¹ SNA 220, *Kontrolli i Cilësisë për një Auditim të Pasqyrave Financiare*, paragrafët 12-13.

² SNA 220, paragrafët 9-11.

³ SNA 210, *Rënia Dakort për Termit e Angazhimeve të Auditimit*, paragrafët 9-13.

- (e) Përcaktojë natyrën, afatin dhe shtrirjen e burimeve të nevojshme për kryerjen e angazhimit. (Ref: Para. A8-A11)
9. Audituesi do të zhvillojë një plan auditimi që do të përfshijë një përshkrim të:
- (a) Natyrës, afatit dhe shtrirjes së procedurave të planifikuara të vlerësimit të rrezikut, siç përcaktohet në SNA 315 (i rishikuar).⁴
 - (b) Natyrës, afatit dhe shtrirjes së procedurave të mëtejshme të planifikuara të auditimit tjera në nivel të pohimit, siç përcaktohet në SNA330.⁵
 - (c) Procedura të tjera të planifikuara të auditimit që kërkohet të kryhen, në mënyrë që angazhimi të jetë në pajtim me SNA-të. (Ref: Para. A12)
10. Audituesi do të përditësojë dhe ndryshojë strategjinë e përgjithshme dhe planin e auditimit sipas nevojës, gjatë kryerjes së auditimit. (Ref: Para. A15)
11. Audituesi do të planifikojë natyrën, afatin dhe shtrirjen e drejtimit dhe të mbikqyrjes së anëtarëve të grupit të angazhimit si dhe rishikimin e punës së tyre. (Ref: Para. A16-A17)

Dokumentimi

12. Audituesi do të përfshijë në dokumentacionin e auditimit:⁶
- (a) Strategjinë e përgjithshme të auditimit;
 - (b) Planin e auditimit; dhe
 - (c) Çdo ndryshim të rëndësishëm të bërë gjatë angazhimit të auditimit, në strategjinë e përgjithshme dhe planin e auditimit, dhe arsyet e këtyre ndryshimeve. (Ref: Para. A18-A21)

Konsiderata Shtesë për Angazhimet Fillestare të Auditimit (që kryhen për herë të parë)

13. Përpara se të nisë një auditim që kryhet për herë të parë, audituesi do të realizojë aktivitetet e mëposhtme:
- (a) Të kryejë procedurat e kërkuara nga SNA 220 në lidhje me pranimin e marrëdhënieve me klientin dhe angazhimin specifik të auditimit;⁷ dhe

⁴ SNA 315 (i rishikuar), *Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale Nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të tij*.

⁵ SNA 330, *Përgjigjet e Audituesit ndaj Rreziqeve të Vlerësuar*.

⁶ SNA 230, *Dokumentimi i Auditimit*, paragrafët. 8-11, dhe A6.

⁷ SNA 220, paragrafët 12-13.

- (b) Të komunikojë me audituesin e mëparshëm, kur ka patur ndryshim të audituesve, në pajtim me kërkesat etike të përshtashme. (Ref: Para. A22)

Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese

Roli dhe Afati i Planifikimit (Ref: Para. 2)

- A1. Natyra dhe shtrirja e veprimtarive të planifikimit do të ndryshojë sipas madhësisë dhe kompleksitetit të entitetit, eksperiencës së mëparshme të anëtarëve kryesorë të grupit të angazhimit me entitetin, dhe ndryshimeve në rrethanat, që ndodhin gjatë angazhimit të auditimit.
- A2. Planifikimi nuk është një fazë e veçantë e auditimit, por një proces i vazhdueshëm dhe ndërveprues që fillon menjëherë (ose lidhet) me përfundimin e auditimit të mëparshëm dhe vazhdon derisa të përfundojë angazhimi i auditimit aktual. Megjithatë, planifikimi, përfshin marrjen në konsideratë të aktiviteteve dhe procedurave të caktuara të auditimit që duhet të përfundojnë para kryerjes së procedurave të auditimit të mëtejshme. Për shembull, planifikimi përfshin nevojën që audituesi të marrë në konsideratë, përpara identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut të anomalise materiale, çështje të tilla si:
- Procedurat analitike që duhet të përdoren si procedura të vlerësimit të rrezikut.
 - Arritjen e një kuptimi të përgjithshëm të kuadrit rregullator dhe ligjor të zbatueshëm për entitetin dhe të mënyrës se si entiteti e zbaton këtë kuadër.
 - Përcaktimi i materialitetit.
 - Përfshirja e ekspertëve.
 - Kryerja e procedurave të tjera të vlerësimit të rrezikut.
- A3. Audituesi mund të vendosë të diskutojë elementët e planifikimit me drejtuesit e entitetit për të lehtësuar kryerjen dhe drejtimin e angazhimit të auditimit (për shembull, të koordinojë disa procedura të auditimit të planifikuara, me punën e personelit të entitetit). Ndonëse këto diskutime ndodhin shpesh, strategjia e përgjithshme dhe planifikimi i auditimit mbeten përgjegjësi e audituesit. Kur diskutohen çështje të përfshira në strategjinë e përgjithshme dhe planin e auditimit, duhet të tregohet kujdesi i nevojshëm për të mos kompromentuar efektivitetin e auditimit. Për shembull, diskutimi i natyrës dhe afateve të procedurave të detajuara të auditimit me drejtuesit, mund të kompromentojë efektivitetin e auditimit duke i bërë procedurat e auditimit tepër të parashikueshme.

Përfshirja e Anëtarëve Kryesorë të Grupit të Angazhimit (Ref: Para. 5)

A4. Përfshirja e ortakut të angazhimit dhe e anëtarëve të tjerë të grupit të angazhimit në planifikimin e auditimit sjell eksperiencë dhe vizion duke shtuar në këtë mënyrë, efektivitetin dhe eficientësinë e procesit të planifikimit.⁸

Aktivitetet Paraprake të Angazhimit (Ref: Para. 6)

A5. Kryerja, në fillim të angazhimit aktual të auditimit, e aktiviteteve paraprake të angazhimit të specifikuara në paragrafin 6, e ndihmon audituesin në identifikimin dhe vlerësimin e ngjarjeve ose rrethanave që mund të ndikojnë negativisht në aftësinë e audituesit për të planifikuar dhe kryer angazhimin e auditimit.

A6. Kryerja e këtyre aktiviteteve paraprake të angazhimit i jep mundësi audituesit të planifikojë një angazhim auditimi për të cilin, për shembull:

- Audiuesi ruan pavarësinë dhe aftësinë e nevojshme për të kryer angazhimin.
- Nuk ka probleme me integritetin e drejtimit, të atilla që mund të ndikojnë gadishmërinë e audiuesit për të vazhduar angazhimin.
- Nuk ka keqkuptime me klientët përse i përket kushteve të angazhimit.

A7. Vlerësimi prej audituesit i kushteve për vazhdimin e marrëdhënieve me klientin dhe i kërkesave etike të përshtatshme, duke përfshirë pavarësinë, ndodh gjatë gjithë angazhimit të auditimit përse kohë që ndodhin ndryshime në rrethana dhe kushte. Kryerja e procedurave fillestare si për vazhdimin e marrëdhënieve me klientin, ashtu edhe për vlerësimin kërkesave etike të përshtatshme (përfshirë pavarësinë) në fillim të angazhimit aktual të auditimit, do të thotë që ato janë përfunduar para kryerjes së aktiviteteve të tjera të rëndësishme për angazhimin e auditimit aktual. Për vazhdimin e angazhimeve të auditimit, këto procedura fillestare shpesh kryhen menjëherë pas (ose lidhen me) përfundimit të auditimit të mëparshëm.

Planifikimi i Veprimtarive*Strategjia e Përgjithshme e Auditimit* (Ref: Para. 7-8)

A8. Procesi i hartimit të strategjisë së përgjithshme të auditimit ndihmon audituesin të përcaktojë, subjekt i kryerjes së procedurave të vlerësimit të rrezikut nga audituesi, çështje të tilla si:

⁸ SNA 315, paragrafi 10, përcakton kërkesa dhe jep udhëzime mbi diskutimet e grupit të angazhimit për ndjeshmërinë e entitetit ndaj anomalive materiale të pasqyrave financiare. SNA 240 *Përgjegjësitë e Audituesit në lidhje me Mashtrimin në një Auditim të Pasqyrave Financiare*, paragrafi 15, jep udhëzime mbi theksin që jepet gjatë diskutimit për ndjeshmërinë e pasqyrave financiare ndaj anomalisë materiale për shkak të mashtrimit.

PLANIFIKIMI I AUDITIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE

- Burimet për t'u përdorur në fusha specifike të auditimit, si përdorimi i përshtatshëm i anëtarëve të grupit me eksperiencë në fusha me rrezik të lartë, ose përfshirja e ekspertëve në çështjet komplekse;
- Sasinë e burimeve për t'u shpërndarë në fusha specifike të auditimit, siç janë numri i anëtarëve të grupit të caktuar për të vëzhguar numërimin e inventarit në vendet e magazinimit, shtrirjen e shqyrtimit të punës së audituesve të tjerë në rastin e auditimit të grupit, ose orët e buxhetuara të auditimit për t'u shpërndarë në fushat me rrezik të lartë;
- Koha kur këto burime duhet të përdoren, si për shembull në një fazë të ndërmjetme të auditimit apo në datat kryesore që kanë të bëjnë me ndarjen e priudhave; dhe
- Mënyrën se si këto burime menaxhohen, drejtohen dhe mbikqyren, si për shembull kur janë parashikuar të mbahen takimet e informimeve e të dhënies së udhëzimeve, si janë parashikuar të bëhen rishikimet nga ortaku i angazhimit dhe menaxheri (për shembull, në vendin e punës apo jashtë tij), dhe fakti nëse duhet të kryhen rishikimet për qëllime të kontrollit të cilësisë së angazhimit.

A9. Shtojca liston shembuj të konsideratave që mbahen parasysh në hartimin e strategjisë së përgjithshme të auditimit.

A10. Pas hartimit të strategjisë së përgjithshme të auditimit, mund të zhvillohet një plan auditimi që trajton çështjet e ndryshme të identifikuara në strategjinë e përgjithshme të auditimit, duke patur parasysh nevojën për të arritur objektivat e auditimit nëpërmjet përdorimit eficient të burimeve të audituesit. Hartimi i strategjisë së përgjithshme dhe planit të detajuar të auditimit nuk janë domosdoshmërisht procese të ndara apo në vijimësi, por janë të ndërlidhura ngushtë me njëri tjetrin, për shkak se ndryshimet tek njëri mund të çojnë në ndryshime tek tjetri.

Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Vogla

A11. Në auditimet e entiteteve të vogla, i gjithë auditimi mund të kryhet nga një grup shumë i vogël. Shumë auditime të entiteteve të vogla realizohen nga ortaku i angazhimit (i cili mund të jetë një person fizik i vetëm) që punon me grupin e angazhimit (ose pa ndonjë anëtar të grupit të angazhimit). Në rastin e një grupi më të vogël, koordinimi dhe komunikimi ndërmjet anëtarëve të grupit është më i lehtë. Hartimi i strategjisë së përgjithshme të auditimit për auditimin e entiteteve të vogla nuk është e nevojshme të jetë një proces kompleks dhe që kërkon kohë; ai ndryshon në varësi të madhësisë së entitetit, kompleksitetit të auditimit, dhe madhësisë së grupit të angazhimit. Për shembull, një memorandum i përgatitur pas përfundimit të auditimit të mëparshëm, bazuar në shqyrtimin e fletëve të punës dhe duke nënvizuar çështjet e identifikuara gjatë auditimit të përfunduar, i përditësuar në periudhën aktuale bazuar në diskutimet me drejtuesin-pronar, mund të shërbejë si strategji e dokumentuar auditimi për angazhimin aktual të auditimit, nëse mbulon çështjet e shënuara në paragrafin 8.

Plani i Auditimit (Ref: Para.9)

- A12. Plani i auditimit është më i detajuar se sa strategjia e përgjithshme e auditimit për faktin se ai përfshin natyrën, afatet dhe shtrirjen e procedurave të auditimit që do të kryhen nga anëtarët e grupit të angazhimit. Planifikimi i këtyre procedurave të auditimit bëhet gjatë kryerjes së auditimit, ndërkohë që zbatohet plani i auditimit për angazhimin. Për shembull, planifikimi nga audituesi i procedurave të vlerësimit të rrezikut ndodh në fillim të procesit të auditimit. Megjithatë, planifikimi i natyrës, afatit dhe shtrirjes së procedurave të mëtejshme specifike të auditimit, varet nga rezultati i këtyre procedurave të vlerësimit të rrezikut. Për më tepër, audituesi mund të fillojë ekzekutimin e procedurave të mëtejshme të auditimit për disa klasa transaksionesh, teprica llogarish dhe informacione shpjeguese të dhëna, përpara planifikimit të gjithë procedurave të mbetura të mëtejshme të auditimit.
- A13. Përcaktimi i natyrës, afateve dhe shtrirjes së procedurave të planifikuara të vlerësimit të rrezikut, dhe procedurave të mëtejshme të auditimit, për shkak se lidhja e tyre me informacionet shpjeguese është e rëndësishme në dritën si të gamës së gjerë të informacionit, ashtu edhe të nivelit të detajeve që mund të përfshihen në këto informacione shpjeguese. Për më tepër, disa informacione shpjeguese mund të kenë përmbajtje që nuk është marrë nga librat kontabël të përgjithshëm dhe ndihmës, të cilat kanë ndikim në rreziqet e vlerësuara dhe në natyrën, afatet dhe shtrirjen e procedurave të auditimit që duhen kryer për t'i adresuar ato.
- A14. Marrja në konsideratë e informacioneve shpjeguese qysh herët gjatë auditimit, e ndihmon audituesin t'i kushtojë vëmendjen e duhur kohës së mjaftueshme të planifikuar për adresimin e informacioneve shpjeguese në të njëjtën mënyrë sikurse adresohen edhe klasat e transaksioneve, ngjarjet dhe tepricat e llogarive. Një konsiderim i drejtë, gjithashtu mund të ndihmojë audituesin të përcaktojë efektet në auditim të:
- Informacioneve shpjeguese të rëndësishëm të reja ose të rishikuara, të kërkuara si rrjedhojë e ndryshimeve në mjedisin, kushtet financiare ose veprimtaritë e entitetit (për shembull një ndryshim në identifikimin e kërkuar të segmenteve dhe të raportimit të informacioneve të segmentuara që rrjedhin nga një kombinim biznesi i rëndësishëm);
 - Informacioneve shpjeguese të rëndësishëm të reja ose të rishikuara, që rrjedhin nga ndryshimet në kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.
 - Nevojës për të përfshirë një ekspert të audituesit për të ndihmuar me procedurat e auditimit që lidhen me disa informacione shpjeguese të caktuara (për shembull, informacionet shpjeguese që lidhen me detyrimet për pensionet ose detyrimet e përfitimeve nga dalja në pension); dhe

- Çështjet që lidhen me informacionet shpjeguese që audituesi mund t'i diskutojë me personat e ngarkuar me qeverisjen⁹

Ndryshime në Vendimet e Planifikimit gjatë Kryerjes së Auditimit (Ref: Para.10)

A15. Si rezultat i ngjarjeve të papitura, i ndryshimeve të kushteve, ose evidencës së auditimit të siguar nga rezultatet e procedurave të auditimit, audituesi mund të modifikojë strategjinë e përgjithshme dhe planin e auditimit dhe në këtë mënyrë natyrën, afatin dhe shtrirjen e procedurave të mëtejshme të auditimit bazuar në vlerësimin e rishikuar të rreziqeve të vlerësuara. Këtu mund të jetë rasti kur informacioni që audituesi merr ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga informacioni që audituesi kishte në dispozicion kur ai planifikoi procedurat e auditimit. Për shembull, evidenca e auditimit e siguar nëpërmjet kryerjes së procedurave thelbësore mund të jenë në kontradikte me evidencën e auditimit të siguar nëpërmjet testeve të kontrollit.

Drejtimi, Mbikëqyrja dhe Kontrolli (Ref: Para. 11)

A16. Natyra, afati dhe shtrirja e drejtimit dhe mbikëqyrjes së grupit të angazhimit dhe kontrolli i punës së tyre varet nga shumë faktorë, përfshirë:

- Madhësinë dhe kompleksitetin e entitetit.
- Fushën e auditimit.
- Rreziqet e vlerësuara të anomalisë materiale (për shembull, një rritje në rrezikun e vlerësuar të anomalisë materiale për një fushë të auditimit të dhënë, zakonisht kërkon një rritje korresponduese në shtrirjen dhe afatin kohor të drejtimit dhe të mbikëqyrjes së grupit të angazhimit, dhe një kontroll më të detajuar të punës së tyre).
- Aftësitë dhe kompetencën e anëtarëve individualë të grupit të auditimit që kryejnë punën audituese.

SNA 220 përmban udhëzime të mëtejshme për drejtimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e punës audituese.¹⁰

Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Vogla

A17. Në qoftë se auditimi kryhet plotësisht nga ortaku i angazhimit, nuk do të lindin çështje që kanë të bëjnë me drejtimin dhe mbikëqyrjen e anëtarëve të grupit të angazhimit dhe me rishikimin e punës së tyre. Në këto raste, ortaku i angazhimit, duke qënë se i ka drejtuar personalisht të gjitha aspektet e punës, do të jetë i vetëdijshëm për të gjitha

⁹ SNA 260 (i rishikuar), *Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen*, paragrafi A13

¹⁰ SNA 220, paragrafët 15 – 17.

çështjet materiale. Formimi i një pamje objektive mbi përshtatshmërinë e gjykimeve të bëra gjatë auditimit, mund të paraqesë probleme praktike kur i njëjti individ kryen gjithashtu, të gjithë auditimin. Nëse ka çështje që janë veçanërisht komplekse ose të pazakonta dhe auditimi kryhet nga një person fizik i vetëm, mund të jetë e dëshirueshme që të ketë konsultim me auditues të tjerë që kanë eksperiencën e duhur ose me organizmin profesional të audituesve.

Dokumentimi (Ref: Para. 12)

A18. Dokumentimi i strategjisë së përgjithshme të auditimit është një regjistrim i vendimeve kryesore, që konsiderohen të nevojshme për të planifikuar auditimin në mënyrë të përshtatshme si edhe për të komunikuar çështjet e rëndësishme tek grupi i angazhimit. Për shembull, audituesi mund të përmbledhë strategjinë e përgjithshme të auditimit në formën e një memorandumit që përmban vendimet kyçe në lidhje me qëllimin e përgjithshëm, afatin dhe kryerjen e auditimit.

A19. Dokumentimi i planit të auditimit është regjistrimi i natyrës, afateve dhe shtrirjes së procedurave të vlerësimit të rrezikut të planifikuara dhe të procedurave të mëtejshme të auditimit në nivel pohimi si përgjigje ndaj rreziqeve të vlerësuara. Ai përmban gjithashtu, edhe të dhëna mbi planifikimin e duhur të procedurave të auditimit që mund të rishikohen dhe aprovohen përpara kryerjes së tyre. Për kryerjen e auditimit, audituesi mund të përdorë programe auditimi standarde ose lista kontrolli, të përpunuara si pas nevojës për të reflektuar rrethanat e veçanta të angazhimit.

A20. Një regjistrim i ndryshimeve të rëndësishme të strategjisë së përgjithshme dhe planit të auditimit, dhe i ndryshimeve që rezultojnë mbi natyrën, afatin dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të planifikuara, shpjegon arsyen pse janë bërë këto ndryshime të rëndësishme, dhe strategjinë e përgjithshme dhe planin e auditimit përfundimtar të miratuar për auditimin. Ai gjithashtu, reflekton përgjigjen e duhur për ndryshimet e rëndësishme që ndodhin gjatë auditimit.

Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Vogla

A21. Siç u diskutua në paragrafin A11, një memorandum i shkurtër dhe i përshtatshëm mund të shërbejë si strategji e dokumentuar për auditimin e një entiteti të vogël. Për planin e auditimit, mund të përdoren programet standarde të auditimit ose listat e kontrollit (shiko paragrafin A19) të hartuara mbi supozimin se ka pak aktivitete kontrolli të përshtatshme, siç mund të jetë rasti i entiteteve të vogla, duke pasur parasysh që ato të jenë të përpunuara sipas rrethanave të angazhimit, duke përfshirë vlerësimet e rrezikut që bën audituesi.

Konsiderata Shtesë në Angazhimet e Auditimit Fillestare (Ref: Para. 13)

A22. Qëllimi dhe objektivi i planifikimit të auditimit janë të njëjte si në rastin kur auditimi është një angazhim fillestar ashtu edhe kur ai është një angazhim që përsëritet. Megjithatë, për një auditim fillestar, audituesi mund të ketë nevojë për të zgjeruar

aktivitetet planifikuese, sepse audituesi zakonisht, nuk ka eksperiencën e mëparshme me entitetin, që mbahet parasysh kur planifikohen angazhimet që përsëriten. Për një angazhim auditimi fillestar, çështje të tjera që audituesi mund të marrë në konsideratë kur ai harton strategjinë e përgjithshme dhe planin e auditimit përfshijnë si më poshtë:

- Përveç nëse nuk është e ndaluar nga ligji apo rregullat, marrëveshjet që duhen bërë me audituesin paraardhës, për shembull, për të rishikuar fletët e punës të audituesit paraardhës.
- Çdo çështje të rëndësishme (duke përfshirë aplikimin e parimeve të kontabilitetit ose standardet e raportimit dhe të auditimit) të diskutuar me drejtimin në lidhje me zgjedhjen për herë të parë si auditues, komunikimi i këtyre çështjeve me personat e ngarkuar me qeverisjen dhe se si këto çështje ndikojnë në strategjinë e përgjithshme dhe planin e auditimit.
- Procedurat e auditimit që nevojiten për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit në lidhje me tepricat e çeljes.¹¹
- Procedura të tjera që kërkohen nga sistemi i kontrollit të cilësisë së firmës për angazhimet fillestare të auditimit (për shembull, sistemi i kontrollit të cilësisë së firmës mund të kërkojë përfshirjen e një ortaku tjetër ose të një individi me eksperiencë, për të rishikuar strategjinë e përgjithshme të auditimit përpara fillimit të procedurave të rëndësishme të auditimit ose të rishikojë raportet përpara lëshimit të tyre).

¹¹ SNA 510, *Angazhimet Fillestare të Auditimit – Tepricat e Çeljes*.

Shtojcë

(Ref: Para. 7 – 8, A8 – A11)

Konsiderata në Hartimin e Strategjisë së Përgjithshme të Auditimit

Kjo shtojcë jep shembuj të çështjeve që audituesi mund të marrë në konsideratë kur harton strategjinë e përgjithshme të auditimit. Shumë nga këto çështje do të influencojnë edhe planin e detajuar të audituesit. Shembujt e dhënë mbulojnë një fushë të gjerë të çështjeve që zbatohen në shumë angazhime. Ndërsa disa nga çështjet të përmendura më poshtë mund të kërkojnë nga SNA-të e tjera, jo të gjitha ato janë të përshtatshme për çdo angazhim auditimi dhe lista nuk është medoemos e plotë.

Karakteristika të angazhimit

- Kuadri i raportimit financiar mbi të cilin informacioni financiar që do të auditohet është përgatitur, duke përfshirë çdo nevojë për bashkërendim me një kuadër tjetër të raportimit financiar.
- Kërkesat raportuese specifike për sektorët e ekonomisë, të tilla si raportet që kërkojnë nga rregullatorët e sektorit.
- Mbulimi i pritshëm i auditimit, duke përfshirë numrin dhe vendet e entiteve që duhet të përfshihen.
- Natyra e marrëdhënieve të kontrollit ndërmjet një shoqërie mëme dhe entiteteve të kontrolluara të saj që përcaktojnë mënyrën sesi duhet të konsolidohet grupi.
- Shkalla në të cilën entitetet e kontrolluara auditohen nga auditues të tjerë.
- Natyra e segmenteve të biznesit që do të auditohen, duke përfshirë nevojën për njohje të specializuara.
- Monedha që do të përdoret në raportim, duke përfshirë çdo nevojë për përkthimin e monedhës për informacionin financiar të audituar.
- Nevoja për një auditim ligjor të pasqyrave financiare të pavarura si shtesë të auditimit për qëllime konsolidimi.
- Nëse entiteti ka një auditim të brendshëm dhe përcaktimi i fushës dhe masës në të cilën mund të përdoret puna e tij, ose nëse audituesit e brendshëm mund të përdoren për të dhënë ndihmë të drejtpërdrejtë, për qëllim të auditimit.
- Përdorimi i organizatave të shërbimit nga entiteti dhe mënyra se si audituesi mund të sigurojë evidencë në lidhje me ndërtimin dhe operimin e kontrolleve të kryera nga ato.

- Përdorimi i pritshëm i evidencës së auditimit të siguruar në auditimet e mëparshme, për shembull, evidencat e auditimit në lidhje me procedurat e vlerësimit të rrezikut dhe testet e kontrolleve.
- Efekti i teknologjisë së informacionit në procedurat e auditimit, duke përfshirë disponueshmërinë e të dhënave dhe përdorimin e pritshëm të teknikave të auditimit të bazuara në kompjuter.
- Koordinimi i mbulimit të pritur dhe afatit të punës së auditimit me çdo rishikim të informacionit financiar të ndërmjetëm dhe efekti në auditim i informacionit të siguruar gjatë këtyre rishikimeve.
- Disponueshmëria e personelit dhe të dhënave të klientit.

Objektivat e Raportimit, Afati i Auditimit, dhe Natyra e Komunikimeve

- Afati kohor i entitetit për raportim, si në fazat e ndërmjetme ashtu edhe në atë finale.
- Organizimi i takimeve me drejtimin dhe me personat e ngarkuar me qeverisjen për të diskutuar natyrën, afatin dhe shtrirjen e punës së auditimit.
- Diskutimi me drejtimin dhe me personat e ngarkuar me qeverisjen në lidhje me tipin dhe kohën e raportimit dhe për komunikimet e tjera, të shkruara dhe me gojë, duke përfshirë raportin e audituesit, letrat e drejtimin dhe komunikimet me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen.
- Diskutimi me drejtimin në lidhje me komunikimet e pritura mbi gjëndjen e punës së auditimit gjatë gjithë angazhimit.
- Komunikimet me audituesit e entitive të kontrolluara në lidhje me afatin dhe tipet e pritura të raportimeve dhe komunikimet e tjera në lidhje me auditimin e entitive te kontrolluar.
- Natyra e pritur dhe afati i komunikimeve ndërmjet anëtarëve të grupit të angazhimit, duke përfshirë natyrën dhe afatet e takimeve të grupit dhe kohën e rishikimit të punës së kryer.
- Faktin nëse ka ndonjë komunikim tjetër i pritur me palët e treta, duke përfshirë çdo përgjegjësi të raportimit kontraktual apo ligjor që lind gjatë auditimit.

Faktorët e Rëndësishëm, Aktivitetet e Angazhimit Paraprak, dhe Njohuritë e Fituara në Angazhimet e Tjera

- Përcaktimi i materialitetit në përputhje me SNA 320¹² dhe, kurdoherë që është i zbatueshëm:
 - Përcaktimi i materialitetit të entiteteve të kontrolluara dhe komunikimi me audituesit e ketyre entitive në përputhje me SNA 600.¹³
 - Identifikimi paraprak i elementëve të rëndësishëm dhe materialitetit të klasave të transaksioneve, tepricave në llogari dhe informacioneve shpjeguese të dhëna.
- Identifikimi paraprak i fushave ku mund të ketë një rrezik më të lartë të anomalisë materiale.
- Impakti i rrezikut të vlerësuar të anomalisë materiale në nivel të përgjithshëm të pasqyrës financiare mbi drejtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin.
- Mënyrën sipas të cilës audituesi thekson tek anëtarët e grupit të angazhimit nevojën për të patur një qëndrim dyshues ndaj çështjeve dhe për të shprehur skepticizëm profesional në mbledhjen dhe vlerësimin e evidencës së auditimit.
- Rezultatet e auditimeve të mëparshëm që kishin të bënin me vlerësimin e efektivitetit të funksionimit të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë natyrën e mungesave të identifikuar.
- Diskutimi i çështjeve që mund të ndikojnë në auditim me personelin përgjegjës për kryerjen e shërbimeve të tjera për entitetin.
- Evidencë që tregon për angazhimin e drejtimit për ndërtimin, zbatimin dhe mbajtjen e një kontrolli të brendshëm të fortë, duke përfshirë evidencën e dokumentimit të duhur të këtij kontrolli të brendshëm.
- Ndryshimet ne kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, siç janë ndryshimet në standardet e kontabilitetit, të cilat mund të përfshijnë informacione shpjeguese të rëndësishëm të reja, ose të rishikuara
- Volumi i transaksioneve, i cili mund të përcaktoje nëse për audituesin është më efiçiente të mbështetet në kontrollin e brendshëm.
- Rëndësia që i jepet kontrollit të brendshëm në të gjithë entitetin për një veprim të suksesshëm të biznesit.

¹² SNA 320, *Materialiteti në Planifikimin dhe Kryerjen e një Auditimi*.

¹³ SNA 600, *Konsiderata të Veçanta – Auditimet e Pasqyrave Financiare të Grupit (Përfshirë Punën e Audituesve të Entiteteve të Kontrolluara)*, paragrafët 21 -23, dhe 40 (c).

- Proceset që zbaton drejtimi për të identifikuar dhe përgatitur informacionet shpjeguese të kërkuara nga kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar, përfshirë informacionet shpjeguese që përmbajnë të dhëna të marra jashtë librave kontabël të përgjithshëm dhe ndihmës.
- Zhvillime të rëndësishme të biznesit që ndikojnë tek entiteti, duke përfshirë ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe në proceset e biznesit, ndryshimet në drejtimin e lartë, blerjet, shkrirjet dhe shitjet.
- Zhvillime të rëndësishme të sektorit të ekonomisë të tilla si ndryshimet në rregulloret e sektorit dhe kërkesat e reja të raportimit.
- Zhvillime të tjera të rëndësishme, të tilla si ndryshimet në mjedisin ligjor që ndikojnë tek entiteti.

Natyrë, Afatet dhe Shtrirja e Burimeve

- Zgjedhja e grupit të angazhimit (përfshirë, kur është e nevojshme, kontrollorin e cilësisë së angazhimit) dhe caktimi i punës audituese për anëtarët e grupit, duke përfshirë caktimin e anëtarëve me eksperiencën e duhur për fushat ku mund të ketë rreziqe të larta të anomalisë materiale.
- Buxhetimi i angazhimit, duke përfshirë, marrjen në konsideratë të sasisë së duhur të kohës që duhet parashikuar për fushat ku mund të ketë rreziqe të larta të anomalisë materiale.